



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 344/2 Prot.

Rrëshen me, 30. 01 . 2026

V E N D I M

Nr. 10 datë 26. 01. 2026

PËR

“MIRATIM E PAGESËS SË PLOTË, PËR TË DHËNAT E QIRASË MESATARE, NË TREGUN E BANESAVE PËR QARKUN LEZHË, SIPAS SHKRESËS NR. 22412 PROT, DATË 06.12.2019”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 38, të ligjit nr. 22/2018, “Për Strehimin Social” pika 4/a, VKM nr. 362, datë 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes së tij”, Vendimin nr. 50 datë 11.12.2019, “Për miratimin e pagesë së plotë sipas shkresës nr. 22412prot datë 06.12.2019, “Për të dhënat e qirasë mesatare në tregun e banesave për Qarkun Lezhë”, bashkia Mirditë, relacionin nr. 344 prot, datë 21.01.2026, së bashku me projekt-vendimin e Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesës së plotë të qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare, sipas shkresës nr. 22412 prot, datë 06.12.2019, Për të dhënat mbi qiratë mesatare në tregun e banesave për Qarkun Lezhë”
 - a) Qiraja për strukturën e apartamentit 1+1 është 12 600 lekë
 - b) Qiraja për strukturën e apartamentit 2+1 është 15 400 lekë
 - c) Qiraja për strukturën e apartamentit 3+1 është 20 400 lekë
2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura sipas relacionit dhe projekt-vendimit, përkatësisht me nr. 344 & 344/1, prot, datë 21.01.2026 bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor. nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA SHENJ: “ABAT DOÇI”, RRESHEN

KRYETAR

Aleksandër PICAKU



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 344/prot.
11

Rrëshën 21.01.2026.

P/VENDIM

Nr. 9 Datë 21.01.2026

PËR

**“ MIRATIMIN E PAGESËS SË PLOTË PËR TË DHËNAT E QIRASË MESTARE
NË TREGUN E BANESAVE PËR QARKUN LEZHË” SIPAS SHKRESËS 22412
PROT DATË 06.12.2019, BASHKIA MIRDITË”**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a Vkm nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes së tij” Vendimin nr.50 datë 11.12.2019, Për miratimin e pagesë së plotë sipas shkresës nr. 22412prot datë 06.12.2019 Për të dhënat e qirasë mesatare në tregun e banesave për Qarkun Lezhë”, bashkia Mirditë, me propozim të kryetarit të bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës së plotë të qirasë për një periudhë 1 (NJË) vjeçare, sipas shkresës nr. 22412 Prot, datë 06.12.2019, Për të dhënat mbi qiratë mesatare në tregun e banesave për Qarkun Lezhë”
 - a) Qiraja për strukturën e apartamentit 1+1 është 12 600 lekë
 - b) Qiraja për strukturën e apartamentit 2+1 është 15 400 lekë
 - c) Qiraja për strukturën e apartamentit 3+1 është 20 400 lekë
2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë , Drejtoria Planifikimit të Zhvillimit.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHËN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

telex dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ

KRYETAR

Aleksandër PICA KU

Paraqitën Projektin:

Dr. Planifikimit, Zhvillimit të Territorit : Sp/O.GJIKOLAJ

Drejtör: Ark Juljan TUSHA

Dr. Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët:
Juriste/ Majlinda TOPOLLAJ



KRYETARI

Albert MËLLYSHI





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 344 prot.

Rrëshën 21.01.2026.

RELACION

PËR P/VENDIMIN

**“ MIRATIMIN E PAGESËS SË PLOTË PËR TË DHËNAT E QIRASË MESTARE
NË TREGUN E BANESAVE PËR QARKUN LEZHË” SIPAS SHKRESËS 22412
PROT DATË 06.12.2019, BASHKIA MIRDITË”**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore, nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a VKM nr.362, datë 29.05.2019 “ Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionim e qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes së tij”,

Në kuadër të këtyre detyrimeve dhe me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim, përmes subvencionimit të qirasë si instrument I programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët/familjet të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të këshillit bashkiak vlera maksimale e subvencionimit të qirase sipas nenit 38 pika 1 e ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social

Këshilli i Ministrave me vendim nr.362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyren e llogaritjes së tij”, pika 4/a shprehet që për përcaktimin e vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë duhet ndër të tjera të përcaktohet vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë.

Sa më sipër,bashkia Mirditë nuk ofron shërbime imobilare për ti kontaktuar mbi çmimet sipas strukturave të apartamenteve për të nxjerrë një mesatare dhe në mungesë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat mesatare të qirave për territorin e bashkisë Mirditë në nivel Qarku bazuar në shkresën nr.22412 Prot, datë 06.12.2019 “Për të dhënat mbi qiratë mesatare në tregun e banesave për qarkun Lezhë.

1	Banesa me qira apartament 1+1	1 muaj	12 600 lekë
2	Banesa me qira apartament 2+1	1 muaj	15 400 lekë
3	Banesa me qira apartament 3+1	1 muaj	20 400 lekë

Në këto kushte me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e programit të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, paraqesin për miratim këtë projekt-vendim:“ **Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë**”

Faleminderit!

Drejtoria Planifikimit Zhvillimit të Territorit

Sp/Sektorit të Strehimit/ O.GJIKOLAJ



KRYETARI
Albert MELYSHI

